



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN

VENDIM

Nr.2, datë 03.10.2022

PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK
SHOQËRISË “MER ENERGJI” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Seman.

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik shoqërisë “Mer Energji”, me adresë rruga Sharovës Skrapar Qarku Berat sipas Kontratës së Konkensionit të formës “BOT” Nr.2183 Rep., Nr.1145/1 Kol., të lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (Autoriteti Kontraktues) dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Destaxhei” sh.p.k., dhe “Faqekuqi III” sh.p.k. (Koncesionari) datë 16.10.2018, për ndërtimin e hidrocentralit “Faqekuqi III”, si dhe Kontratën shtesë Konkensionit Nr 15 Rep., Nr.9 Kol., datë 07.01.2022 “Për disa ndryshime në Kontratën e Konkensionit të formës “BOT” Nr.2183 Rep., Nr.1145/1 Kol., për ndërtimin e hidrocentralit “Faqekuqi III”.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:
HEC Faqekuqi III
 - Prodhimi vjetor i parashikuar: 3.936.129 kwh/vit
 - Fuqia e instaluar: 1.300 kwh
 - Vlera totale e investimit: 235,424,059 lekë me TVSH.

Vendndodhja e veprës së marrjes Përroi i Vlushës (degë e lumit Osum)

- X= 528627; Y= 4488873; Z=806 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: 2.2 m³/s
- Prurja mesatare vjetore: 1.88 m³/s
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: 0.14 m³/s
- Prurja ekologjike: 0.15 m³/s

Vendndodhja e godinës së Centralit

- X= 526598; Y= 4485850; Z=725 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja që shkarkohet: 2.2 m³/s

3. Zbatimi i kontratës nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SEMAN

LEFTER SHEHAJ

